D E K R E T
Nr.1489, datë 16.5.1996

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.8084, DATË 7.3.1996 "PËR MIRATIMIN ME DISA SHTESA E NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.1359, DATË 5.2.1996 "PËR DISA NDRYSHIME NË DEKRETIN NR.1254, DATË 19.10.1995 "PËR KOMPENSIMIN E ISH-PRONARËVE TË TOKËS BUJQËSORE, JOBUJQËSORE DHE TË TROJEVE TË ZËNA, ME TROJE NË ZONAT TURISTIKE DHE NË QENDRAT E BANUARA", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8024, DATË 2.11.1995"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Në nenin 7/1, pas fjalëve "Sipas gjendjes kadastrale të datës 1 gusht 1991", shtohen fjalët "Në çdo rast ish-pronarëve nuk u kthehen më shumë se 100 ha pyll" dhe pas fjalëve "Për miratimin e zonave që kanë përparësi zhvillimin e turizmit", shtohen fjalët "dhe në zonat e mbrojtura, përcaktuar me akte ligjore e nënligjore përkatëse".

Neni 2

Në ligjin nr.8084, datë 7.3.1996, neni 1, pika 5, riformulohet:
Pas nenit 7/2 shtohet neni 7/3 me këtë përmbajtje:
"Ish-pronarët ose trashëgimtarët ligjorë të kullotave,livadheve, tokave pyjore dhe pyjeve duhet të paraqesin në komisionin e kthimit dhe kompensimit të pronave në rrethe dokumentet e pronësisë brenda një viti pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.8084, datë 7.3.1996".

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

KUNDËRFIRMOHET
KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE — **Aleksandër Meksi**
PRESIDENTI I REPUBLIKËS — **Sali Berisha**